

Nr. 5374/Prot.
11

Tiranë, më 15. 9. 2022

URDHËR

Nr. 544, Datë 15. 9. 2022

PËR

RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, NGA MASTER PROFESIONAL NË “MËSUESI NË EDUKIMIN FIZIK E SHËNDETËSOR NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, NË MASTER I SHKENCAVE NË “MËSUESI NË EDUKIMIN FIZIK E SHËNDETËSOR”, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë, nga “Master Profesional” në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”, në “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor”, me 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatje 2 vite akademike në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor”, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të studimit, të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor”, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, fillon në vitin akademik 2022-2023.
3. Universiteti i Sporteve të Tiranës, të përmbushë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm në lidhje me përmirësimin e emërimit dhe përmbajtjen e lëndës “Vlerësimi i të nxënësve”, para fillimit të vitit akademik 2022-2023.
4. Universiteti i Sporteve të Tiranës, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të nërcaktuara në legjislacionin në fuqi.

5. Universiteti i Sporteve të Tiranës, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

